

## NEKROLOGJI

### **BAHRI BECI, GJUHËTARI ME KONTRIBUTE TË SHQUARA NË FUSHËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Më 20 gusht 2023 u nda nga jeta gjuhëtari me kontribute të shquara në fushën e studimeve albanologjike, akademik Bahri Beci (lindur në Shkodër më 6 mars 1936).

Profesor B. Beci ia kushtoi jetën e tij studimit të gjuhës shqipe, duke u angazhuar në fusha e kahe shqyrtimesh nga më të larmishmet. Prurjet e tij shkencore janë të lidhura me studime të thelluara për sistemin gjuhësor të shqipes, të historisë së zhvillimit të kësaj gjuhe, të veçantive përdorimore të saj në plan diakronik e sinkronik, të standardizimit të saj dhe veçantive të historisë së atij standardizimi, të përvetësimit të kësaj gjuhe në moshat shkollore nga nxënësit shqiptarë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Ai përshkroi dhe interpretoi mbi baza të qëndrueshme teorike dialektet e të folmet e ndryshme të shqipes, historinë e formimit të dialekteve, strukturën dialektore të shqipes dhe historinë e strukturës dialektore të shqipes, lidhjet e shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, teza dhe hipoteza të lidhura me to (të shprehura nga studiues e albanologë shqiptarë e të huaj), duke përvijuar njëherazi qëndrime vetjake për çështje të caktuara.

Pjesë e plejadës së studiuesve të shquar të mendimit gjuhësor shqiptar që punuan me përkushtim për shqipen në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ai zë vend të veçantë me prurjet e tij shkencore.

Formimi i qëndrueshëm teorik, që vinte prej angazhimeve serioze shkencore si kërkues shkencor, por edhe përvoja e tij si mësimdhënës në kurse universitare e pasuniversitare, si drejtues doktoratash në universitete të ndryshme (Tiranë, Shkodër, Napoli, Kozencë, Shkup, Shën-Peterburg, Paris (1958-1997), specializimi e doktorimi në një prej institucioneve në zë të kërkimit shkencor në Francë (Universiteti Paris III) dhe puna në Laboratorin e Fonetikës Eksperimentale, pranë prof. R. Gsell-it në Institutin e Gjuhësisë dhe Fonetikës së Përgjithshme e të Zbatuar, përvoja si drejtues i grupit për modernizimin e mësimin të gjuhës amtare (1987-1997), puna si pedagog i gjuhës shqipe për të huajt në INALCO, etj., përbënin një kapital të çmueshëm shkencor e intelektual për hapa të sigurt në hullitë që ndërmori akad. Beci në rrugëtimin e tij shkencor në hapësirat e gjuhësisë.

Po ashtu, pjesëmarrja a drejtimi i institucioneve shkencore dhe organeve botuese në to, kombëtare e ndërkombëtare, ishin jo vetëm tregues të autoritetit diskursiv të tij, por edhe mundësi e ushqimit në vijimësi me dije të reja prej fushës në plan evropian e më gjerë (le të kujtojmë se përveç drejtimit në kohë të ndryshme të sektorëve shkencorë a të vetë Institutit të Gjuhësisë dhe organeve botuese, si *Studime filologjike* a *Studia albanica* (1993-1997), ai ishte nënkryetar i Komitetit Kombëtar të Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës Juglindore (AIESSE), koordinator i Shqipërisë në Projektin Evropian për Inxhinierinë e Gjuhës (TELRL), anëtar i Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik pranë Këshillit të Ministrave (1995-1997).

Veprimtaria e tij kërkimore-shkencore nis qysh në rininë e tij të hershme, si punonjës shkencor i Institutit të Gjuhësisë pranë Akademisë së Shkencave në Tiranë (fill pas përfundimit të studimeve universitare, në vitin 1958). Në periudhën mars 1975 - korrik 1977 ai kryen studimet pasuniversitare në Institutin e Studimeve Gjuhësore e Fonetike të Universitetit të Sorbonës së Re (Paris III) në gjuhësi (fonetikë), ku fiton titullin “Doktor i Universitetit të Parisit” në gjuhësi (fonetikë), me temën “Sistemi zanor dhe bashkëtingëllor i së folmes së qytetit të Shkodrës (Shqipëria e Veriut)”. Më tej ai fiton gradën shkencore “Kandidat i shkencave” në gjuhësi, në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1979), me temën “Të folmet qendrore të dialektit të veriut”; titullin shkencor “Bashkëpunëtor i vjetër shkencor” (1979); gradën shkencore “Doktor i shkencave” (1984) me temën “Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës”; titullin shkencor “Profesor/Drejtuës kërkimesh” (1994) dhe në vitin 2008, titullin “Akademik” i ASHSH-së. Gjithashtu ai është dhe “Akademik i jashtëm” i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Me prurjet e tij shkencore, akademik Bahri Beci ka arritur të sjellë një produkt me vlerë sot e gjithë ditën, me studime e zbatime teorish në kahe të tilla shqyrtimesh për shqipen, si dialektet e shqipes dhe struktura dialektore e saj, politika gjuhësore dhe planifikimi gjuhësor, standardizimi i gjuhës dhe historia e standardizimit të shqipes, norma gjuhësore, sistemi gjuhësor dhe probleme të standardizimit, ndikimi i gjuhës letrare mbi dialektet, baza gjuhësore e standardit, variacioni sociolinguistik në areale të caktuara të shqipes, mësimi i gjuhës amtare dhe të huaj, mësimdhënia e shqipes si gjuhë amtare dhe për të huajt, metodat statistikore në shqyrtimin e veçantive të njëjësive të nënsistemeve të shqipes, lëvrimi i shqipes së shkruar e të folur, tekstet shkollore dhe përdorimi i efektshëm i tyre, çështje të përvetësimit të sistemit fonologjik e gramatikor të shqipes dhe parimet e drejtshkrimit të saj, etj., etj.

Ai është autor i shumë monografive për çështje të ndryshme nga fushat e dialektologjisë, historisë së gjuhës, shqipes standarde etj., i më se 200 kumtesave e artikujve shkencorë në revista të specializuara shkencore brenda

dhe jashtë vendit, bashkautor i botimeve të veprave madhore kolektive, siç është “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (ADGJSH), 700 harta”, Napoli, 2007; “Atlasi lingvistik evropian (ALE)”, pjesën që lidhet me shqipen, si dhe botimeve në fushën e gjuhësisë së zbatuar, me përqendrim të veçantë në tekstet shkollore për mësimdhënien e gjuhës shqipe.

Mes veprave të tij mund të veçojmë: Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, Tiranë, 1995; Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri, Pejë, 2000; Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, Pejë, 2002; Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, Tiranë, 2002; Fonetika e gjuhës shqipe, Prishtinë, 2004; Tiranë 2004; Gramatika e gjuhës shqipe për mësuesit, Tiranë, 1997, 2004, Prishtinë, 1998, 2002; Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Shkodër, 2000, Prishtinë, 2001, Shkup 2004, Tiranë 2004; Të folmet qendrore të shqipes së veriut (Gegërishtja qendrore dhe grupimi i të folmeve të saj), Tiranë, 2007; Historia e standardizimit të shqipes, Tiranë, 2010; Një libër që nuk do të doja ta shkruaja, Tiranë, 2013; “Homo ideologicus” në shkencën shqiptare, Tiranë, 2015; Struktura dialektore e shqipes, Tiranë, 2016. Historia e formimit të strukturës dialektore të shqipes, Tiranë 2019; L’union linguistique balkanique à la lumière des données de la langue albanaise; Tiranë 2020; Përjetime (1936-2020), Tiranë 2020.

Qysh në rini, e më tej në mënyrë intensive përgjatë tërë veprimtarisë së tij shkencore, akademik Beci u angazhua njëherazi në dy hulli të gjera kërkimi: në disiplina që e shohin objektin e tyre si objekt teorik, të brendshëm në gjuhë (si fonetika, gramatika, dialektologjia, historia e gjuhës shqipe etj.) dhe në ato disiplina që përvijohen nga raporti me një element të jashtëm, nga raporti me praktikën sociale të jashtme (që mund të jenë natyrore – përvetësimi i gjuhës), ose institucionale (përsosja e kompetencës gjuhësore përmes shkollimit). Në këtë mënyrë ai sjell kontribute në aspekte të ndryshme të gjuhësisë së sistemit dhe historinë e gjuhës shqipe dhe dialekteve të saj; por, nga ana tjetër, edhe në gjuhësinë e ligjërimit, në disiplina, disa prej të cilave përshkruajnë apo priren të kuptojnë se ç’ndodh në këto praktika të natyrshme ligjërimore e sociale, dhe disiplina të tjera, të cilat nxjerrin më në pah aspektin prakseologjik, të veprimit njerëzor: pra jo vetëm për të përshkruar, shqyrtuar e interpretuar, por sidomos për të bërë që situata të evoluojë.

Akad. Beci nuk mënoi t’u jepet me të njëjtin përkushtim të dyja këtyre qasjeve ndaj gjuhës dhe ligjërimit; të shqyrtojë deri në imtësi, e me metodologjitë bashkëkohore, veçantitë e sistemit fonetik e gramatikor të shqipes e dialekteve të saj, e njëherazi të studiojë e shkruajë në lidhje me përvetësimin e atij sistemi dhe kushtëzimet që lindin prej atyre veçantive në procesin e të shkruarit, në drejtshkrimin e shqipes; nuk reshti së studiuar veçantitë e sistemit fonetik e gramatikor në dialekte e në standard, e njëherazi

të hartojë një gramatikë të shqipes me karakter popullarizues, për një lexues të gjerë, apo edhe një gramatikë në ndihmë të mësuesve.

Një pjesë jo të vogël të energjive të tij ai ua kushtoi studimit të çështjeve që inkuadrohen në Gjuhësinë e Zbatuar. Me studimet e produktin e tij shkencor për politikën gjuhësore, çështjet e përvetësimit të standardit, të gjuhës së përdorur në komunitete gjeografikisht më të kufizuara, studimet statistikore për njësi të caktuara të nënsistemeve, përgatitjes së materialeve në ndihmë të përdoruesve të shqipes si gjuhë amtare a gjuhë e huaj (gramatikën a metodat për mësimin e shqipes në gjuhë të ndryshme), e po ashtu me korpusin e gjerë të teksteve shkollore të gjuhës shqipe për nxënësit e mësuesit, akademik B. Beci ka hedhur bazat për përvijimin e kaheve të rëndësishme të institucionalizimit konjitiv të Gjuhësisë së Zbatuar në gjuhësinë shqiptare; nga ana tjetër, angazhimet në organizmat e institucionet kombëtare e ndërkombëtare të gjuhësisë i kanë mundësuar të kontribuojë për institucionalizimin social të kësaj dijeje.

Mes dy prirjeve të kërkimit të tij shkencor, mes dy pasioneve e dy hullive në komunikim me njëra-tjetrën, akad. Beci mundi t'i japë status më domethënës misionit të tij në shkencë.

Veprimtarinë e suksesshme kërkimore-shkencore ai e bashkëshoqëroi përgjatë tërë punës së tij me angazhime në strukturat drejtuese shkencore dhe botuese pranë Institutit të Gjuhësisë dhe më gjerë, si Sekretar shkencor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (1974-1976); shef i sektorit të gramatikës dhe të historisë së gjuhës, pranë IGJL-së (1991-1993); anëtar i këshillit shkencor të IGJL-së (1978-1997); anëtar i redaksisë së revistës “Studime filologjike” (1978-1984); sekretar shkencor i revistës “Studime filologjike” (1984-1993); kryeredaktor i revistës “Studime filologjike” (1993-1997); sekretar shkencor i revistës “Studia Albanica” (1993-1997); bashkëdrejtor i Seminareve XVII-XVIII ndërkombëtarë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (1995-1996); anëtar i Këshillit Drejtues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, (1993-1997); drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHSH-së (1993-1997); kryetar i Komitetit kombëtar të Atlasit Gjuhësor Evropian (ALE), Tiranë (1993-1997); nënkryetar i Komitetit Kombëtar të Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës Juglindore (AIESSE), Tiranë (1993-1997); koordinator i Shqipërisë në projektin evropian për inxhinierinë e gjuhës (TELRI), Tiranë (1993-1997); anëtar i Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik pranë Këshillit të Ministrave (1995-1997).

Prurjet e tij shkencore janë mbështetje e sigurt për studime të mëtejshme në lëmë të shqipes dhe një trashëgimi me vlerë të veçantë që ndihmon për ndriçimin gjithnjë e më të plotë të kontekstit epistemologjik në të cilin do të mund të zhvillohen më tej studimet tona në fushat në të cilat ai punoi me

---

përkushtim e pasion, e sidomos me rreptësinë e objektivitetin e një shkencëtari të shquar.

Për përkushtimin dhe vlerën e kontributit të tij, ai është nderuar me :

- Medalje “Naim Frashëri” nga Kuvendi Popullor, Tiranë, 1973.
- Urdhëri “Naim Frashëri” nga Kuvendi Popullor, Tiranë, 1986.
- Dekorata “Për Merita të Veçanta Civile” nga Presidenti i Republikës, Tiranë 2015.

Akademia e Studimeve Albanologjike i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së Akademikut Bahri Baci, të afërmëve dhe kolegëve me të cilët ai punoi përmbi 60 vjet! U prehtë në paqe!

**Tomorr Plangarica**